



# Vlerat dhe Etika në Biznes

Akademia Profesionale ELITA

# Objektivat

- Kuptimi i Etikës në biznes dhe Rëndësia e saj
- Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës
- Si Etika ju bën një person më të mirë?
- Dallimet etike në vendin e punës
- Morali dhe etika në vendin e punës
- Si të trajtohen çështjet etike në punë
- Komunikimi në Biznes -

# Etika në përgjithësi - Kuptimi

**Etika është kodi i përgjithshëm i sjelljes që supozohet të respektohet kur jeton në shoqëri. Qëllimi i sjelljes etike është përmirësimi i vlerës morale në shoqëri.**

**Fjala "Etikë" do të thotë filozofi morale ose parime morale dhe standarde të sjelljes. Etika përfshin shkencën e moralit, parimeve të moralit dhe e gjithë kjo është tërësia e vlerave që drejton sjelljen tonë.**

# Vlerat dhe etika në biznes

Vlerat dhe etika në biznes i referohet parimit ose kodit të sjelljes që ne ndjekim çdo ditë, gjatë transaksioneve tona të biznesit.

Ajo gjithashtu përfshin individët që punojnë në një organizatë, kodin e tyre të sjelljes dhe atë të organizatës në tërësi.

# Rregullat e arta të etikës së biznesit

- **Besueshmëria**
  - **Respekti**
  - **Përgjegjshmëria**
- **Ndershmëria / Drejtësia**
  - **Nderimi / Integriteti**
    - **Profesionalizmi**
- **Respektimi i pronësisë dhe konfidencialitetit**

# Burimet e etikës së përgjithshme

- **Kultura** - një model sjelljesh dhe vlerash që transferohen nga një gjeneratë në tjetrën
- **Feja** - Besohet se etika është një shfaqje e hyjnore, dhe kështu vendos një vijë dalluese midis të mirës dhe të keqes në shoqëri
- **Ligjet** - janë procedura dhe kode sjelljeje, që përcaktohen nga sistemi ligjor i shtetit

# Burimet e etikës së biznesit

- Rregullimi ligjor
- Kodi profesional i etikës
- Kodi organizativ i etikës
  - Vlerat individuale

# Rregullimi ligjor

- Respektimi i lirisë dhe të drejtave të të tjerëve
- Rëndësia e të vepruarit në mirëbesim
- Rëndësia e ushtrimit të kujdesit të duhur
- Rëndësia e nderimit të konfidencialitetit
- Shmangia e konfliktit të interesit



# Kodi profesional i etikës

- Urdhëri i Mjekut
- Urdhëri i Infermierit
- Urdhëri i Psikologut
- Urdhëri i Farmacisitit
- Urdhëri i Stomatologut
- Urdhëri i Veterinerit
- Urdhëri i Punonjësit Social
- etj.

# Kodi organizativ i etikës

**Ndershmëria**

**Siguria e produktit**

**Shëndeti dhe siguria në vendin e punës**

**Konflikti i interesit**

**Drejtësia në shitje**

**Raportimi financiar**

**Marrëdhëniet me furnizuesit**

**Çmimet, faturimi dhe kontraktimi**

**Blerja dhe përdorimi i informacionit për të tjerët**

**Aktivitetet politike**

**Mbrojtja e mjedisit**

**Pronësia intelektuale / Informacionet pronësore**

# Vlerat individuale

## Si të merrni vendime dhe të veproni me etikë

Bëni **5 Pyetje** vetes:

- A e kam menduar, nëse veprimi që mund të ndër marr është i drejtë apo i gabuar?
- A do të jem krenar, kur t'i tregoj familjes time, shefit tim apo një gazetari, për veprimet e mia?
- A jam i bindur se të gjithë do të vepronin, ashtu siç jam duke menduar të veproj?
- A do t'i shkaktojë dëm, të tjerëve apo mjedisit, vendimi im?
- A do ta shkel ligjin me veprimet e mia?

# Rëndësia e Etikës në biznes

Etika e biznesit është një lloj qeverisje bashkëpunuese, që ka të bëjë me vlerat morale të drejtuesve.

Drejtuesit e biznesit duhet të jenë transparentë në marrëdhëniet e tyre të biznesit.

Etika merr parasysh edhe ndjenjat e klientëve, si dhe interesin e palëve të tjera të interesit.


# Rëndësia e Etikës në biznes

- Kënaq nevojat themelore të njeriut
- Krijon besueshmëri ndaj organizatës
- Njerëzit dhe Udhëheqja punojnë së bashku drejt objektivave
- Përmirëson procesin e marrjes së vendimeve dhe cilësinë e tyre
- Siguron fitime në planin afatgjatë
- Ruan dhe ndihmon shoqërinë

# Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës

- Ka 5 dimensione - ku çdo dimension shoqërohet me një vlerë përkatëse.

Kjo qasje na jep grupet thelbësore prej pesë vlerave njerëzore:



# Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës

- Ndihejmojnë në mbajtjen e rregullit.
- Çdo kompani i bën të njohura vlerat dhe etikën e saj punonjësit.
- Një punonjës, nëse nuk ndjek vlerat dhe etikën e vendit të punës, ai mund të pushohet nga puna.

# Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës

## Dedikimi

Punëdhënësit preferojnë që punonjësit të bëjnë përpjekje të sigjerta, pasi ka rënë dakord të bëjë më të mirën, për të ndihmuar kompaninë të lulëzojë

## Integriteti

Integriteti i referohet sjelljes së ndershme. Në botën e biznesit, gjithashtu mund të nënkuptojë të qenit i sigjertë psh. kur bëni një raport shpenzimesh

## Përgjegjësia

Punonjësit, pritët që të veprojnë me përgjegjësi për veprimet e tyre.

## Bashkëpunimi

Është e rëndësishme që punonjësit të jenë lojtarë të ekipit

## Paraqitja

Veshja e duhur, Gjuha e përshtatshme në zyrë, si dhe sjellja me profesionalizëm



# Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës

"In looking for people to hire, you look for three qualities: integrity, intelligence and energy. And if they don't have the first, the other two will kill you."

Warren Buffett



# Etika themelore e vendit të punës

- **Rregullat dhe rregulloret duhet të jenë të njëjta për të gjithë**
- **Politikat e kompanisë duhet të komunikohen qartë për secilin**
- **Kompania duhet të respektojë punonjësin, që të presë të njejtën gjë në këmbim**
- **Kompania duhet t'i sigurojë punonjësve hapësirën e nevojshme**

# Si Etika ju bën një person më të mirë?

- Krijoni besueshmëri në marrëdhënie
- Siguroni kohezionin e ekipit
- Ofroni vlera për punëdhënësit
- Ndiheni mirë personalisht

# Besueshmëria e marrëdhënieve



Punonjësit etikë ndërtojnë besim në marrëdhëniet e tyre në vendin e punës.

Fitimi i besimit ndaj kolegëve tuaj mund të përmirësojë produktivitetin tuaj.


# Kohezioni ekipor

- Ju bën një lojtar më të mirë të ekipit
- Siguron bashkëpunim dhe kontribut në rezultate
- Ndhmon në krijimin dhe sigurimin e një ambienti pozitiv pune

# Vlera për punëdhënësit




Rritet **Emri i mirë** i kompanisë



Mënjanohen problemet juridike dhe ruhet **reputacioni** i kompanisë



Punonjësit etikë janë njerëzit **më të kërkuar** në çdo organizatë



Ju përmbahen politikave etike dhe përdorin **arsyetimin etik** kur marrin vendime

# Ndiheni mirë personalisht

- Bëhesh një person më i mirë për veten tënde, përveç rritjes së vlerës tënde ndaj të tjerëve
- Shmang ngarkesën e fajit dhe paranojës
- Ju jep qetësi mendore, stabilitet emocional dhe aftësi për të kultivuar miqësi të qëndrueshme
- Rrit kënaqësinë tuaj në punë, dhe qetësinë, për jetën në përgjithësi

# Morali dhe Etika

- Morali dhe etika shkojnë së bashku
- Operimi i një biznesi etik dhe moral varet jo vetëm nga mënyra se si sillen **pronarët** dhe **menaxherët**, por edhe si sillen **punonjësit** e kompanisë



# Vendimarrja e moralshme

- Pronari i një biznesi, është përgjegjës për marrjen e vendimeve
- Vendimmarrja etike dhe morale është thelbësore
- Të gjitha vendimet duhet të jenë të drejta, duke lënë mënjanë preferencat personale

# Qëllimet/objektivat dhe politikat

- Çdo biznes duhet t'i ketë të qarta Qëllimet/Objektivat dhe Politikat organizative
- Punonjësit duhet të ndërgjegjësohen që biznesi mban veten – por dhe ata vetë - në një standard më të lartë.
- Biznesi juaj gjithmonë duhet të funksionojë në një mënyrë etike, pavarësisht nga rezultati

# Integriteti i punonjësve dhe kompanisë

- Integriteti është një pjesë e rëndësishme e moralit dhe etikës
- Të gjithë në organizatë duhet të ndërtojnë dhe mbajnë, një standard të lartë personal integriteti
- Informoni punonjësit mbi pritshmëritë, në mënyrë që ata të mund të ndjekin udhëzimet e kompanisë

# Etika dhe Morali ndaj Konkurrencës

- Konkurrenca, qoftë me një kompani tjetër, qoftë midis punonjësve, duhet të udhëhiqet gjithmonë nga etika dhe morali
- Është e nevojshme, që pronarët e bizneseve, të theksojnë se integriteti nuk mund të rrezikohet në asnjë mënyrë, formë apo shfaqje

# Dilemat Morale dhe Etike

- Jo gjithmonë është e lehtë që situatat të zgjidhen në mënyrë morale dhe etike
- Punëdhënësit duhet të mendojnë përpara, për të përcaktuar dhe zbatuar politika të etikës në vendin e punës
- Menaxhmenti duhet të veprojë si një burim frymëzimi për punonjësit
- Komunikimi i vazhdueshëm midis menaxhmentit dhe punonjësve

# Zhvillimi politikave të vendit të punës

1. Zhvillimi i politikave të vendit të punës
2. Njoftimi i punonjësve
3. Përfshirja e zbatimit të politikave në programin e menaxhimit të performancës
4. Rishikimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i politikave
5. Trajnimi i punonjësve për politikën dhe etikën në vendin e punës



**FALEMINDERIT  
&  
SUKSESE!**